



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR ISHËM

VENDIM

Nr.6, datë 10.09.2025

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR NXJERRJE DHE
SHFRYTËZIM TË UJIT NËNTOKËSOR NËPËRMJET SHPIMIT PËR
QËLLIME TË NDRYSHME, TË SUBJEKTIT “UNION PROPERTY
INVESTMENT MANAGEMENT” SH.P.K., ME VENDNDODHJE:
BASHKIA VORË, QARKU TIRANË.**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujrave të pëdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje për nxjerrje dhe shfrytëzim të ujit nëntokësor nëpërmjet shpimit për qëllime të ndryshme, të subjektit “Union Property Investment Management” sh.p.k., me vendndodhje: Bashkia Vorë, Qarku Tiranë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor:

- $X=475188.6$
- $Y=4586714.5$
- $Z=36\text{ m}$

- Prurja mesatare : $Q_{\text{mes}}=1\text{ l/sek}$

- Sasia e ujit që jepet në përdorim : $Q=1\text{ l/sek}$

- Qëllimi i përdorimit : Për qëllime të ndryshme (sanitare) në funksion të aktivitetit në fushën e shërbimeve të automjeteve me qera.

- Thellësia e pus-shpimit: 14.5 m

- Thellësia e vendosjes së pompës : 14.2 m

- Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)

- $X=475149.7;$ $Y=4586708.0;$ $Z=35.8\text{ m}$

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBL ISHËM

EMILJAN JANI

